



Prishtinë,
15.04.2024

Këshilli Administrativ i Byrosë Kosovare të Sigurimit në mbledhjen e datës 15.04.2024, në bazë nenit 21 lidhur me nenin 19 të Statutit të Byrosë Kosovare të Sigurimit, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet manuali për tarifimin e disa automjeteve speciale të punës të cilat regjistrohen për qarkullim sipas legjislacionit në fuqi, në mungesë të grupit tarifor të veçantë e cila do të zbatohet për standardizimin e tarifimit të mjeteve motorike speciale të punës.
- II. Automjetet transportuese apo automjetet speciale të cilat nuk kanë masë bartëse, por kanë vetëm masë totale, për të gjetur masën bartëse duhet aplikuar formula si në vijim:

$$\text{Masa Bartëse} = 55\% * \text{Masa Totale}$$

- III. Rimorkiot të cilat nuk kanë masë bartëse, por kanë vetëm masë totale, për të gjetur masën bartëse duhet aplikuar formula si në vijim:

$$\text{Masa bartëse} = 82\% * \text{Masa Totale}$$

- IV. Ky vendim do të zbatohet deri në caktimin e grupit tarifor të veçantë nga rregullatori lidhur me mjetet motorike speciale të punës, apo ndryshimit të këtij vendimi.
- V. Ky vendim miratohet me vota unanime të anëtarëve të Këshillit Administrativ të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe i njëjti hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Hekuran Nezir

Kryetar i Këshillit Administrativ

